

DRTK SHKODËR

MIRATOHET  
Sekretari i KKTKM  
Ark. Arta Dollani




RELACION TEKNIK

**RESTAURIM DHE KONSERVIM  
URA E MESIT  
SHKODER**

## PROJEKTI I RESTAURIMIT TE URËS SË MESIT




Ura e Mesit është monument kulture i kategorise së parë. E gjithë sipërfaqja është e ndërtuar me gurë e shtruar me kalldrëm. Shpallet monument kulture i kategorisë së parë në vitin 1948. Ura e Mesit e ndërtuar nga Mehmet Pasha Bushati nga fundi i shek XVIII, është një nga urat prej guri më të medha dhe më të ruajtura në vendin tonë. Ajo është një tip me kurriz, e realizuar me mbi 13 harqe me përmasa hapësirash të ndryshme me një gjatësi prej 108m. Ndërtimi i urës ka kaluar ne dy fazë. Fazës së parë i takon harku kryesor me hapësirë drite 21,5m dhe 3 harqe të tjera, traseja e kësaj faze të urës është shtruar me gurë pllakë të vendosur këlllic duke i dhënë harkut të urës pendencën në formë shkallareje. Më vonë, kur me sa duket prurje të mëdha përmbytnin pjesët e pjerrëta në hyrje dhe dalje të urës, lindi nevoja e zgjatjes së saj, duke shtuar 4 harqe nga e majta dhe 5 harqe nga e djathta muratura e të cilit është punuar me kujdes që në fazën e parë.




Në zonën e Shkodrës janë ndërtuar disa ura guri mbi lumenjtë Kir dhe Drin. Lumi Kir, i cili është nga lumenjtë kryesorë në pellgun e Shkodrës, gjatë rrjetes së tij të poshtme kalohej nëpërmjet tre urave: Ura e Shtrenjtë, Ura e Mesit dhe ajo e Kirit. Sot ruhet mjaft mirë Ura e

Mesit e cila e merr emrin nga fshati Mes pranë saj, e cila lidh Shkodrën me Drishtin dhe me krahinën e Cukalit. Sipas gjurmëve në vend vërehet se rruga prej Shkodre në Drisht nuk është kalonte lumin Mes tek ura e sotme, por në veri të saj, nën kodrën e Kalasë së Drishtit, ku edhe sot ndodhen në lumë mbejtje të një ure paraturke. Më vonë, gjatë shekullit te XVIII-të u ndërtua Ura e Mesit dhe rruga me kalldrëm në bregun e majtë të lumbrit Kir, qe lindte fshatrat Mes e Drisht.






➤ Gjendja aktuale



- Ne pjesen hyrse te ures ( Krahu Verior dhe ne dalje Krahu Jugor eshte e nevojshme te krijohet kanale shkarkimi te ujrave te bardha te shiut ,te mbuluara me zgara hekuri, (tip gradaresh) pasi ne raste rreshjesh I gjithe materiali I ngurte depozitohet ne pjesen kaluse te Ures.
- Gjendja e pjeseskaluesështë pa problem







- Parapeti i ures i restaurua pjeserisht ,por nga cilesia le per te desheruar. Mendimi jone eshte kapuçimi i gjithë parapetit te ures ( te dy krahet) me gure e te njejtës ngjyrë dhe forme si qigjet egzistues te qemerve te ures, vendosur mbi një shtrese te holle llaci, me permaza respektive ne gjeresin e parapetit ( 30 x20 deri 30 x 5 ) cm,
- Eshte një nevoj e domosdoshme pastrami i mureve, qemereve nga bimesia e ulet dhe një fugatim i per gjithshem i mureve te ures.
- Zevendesimi i muratures se demtuar ,plotesimi me gure .



- Problemi me i rendesishem mendojme se duhet te trajtohet eshte demtimi dhe copetimi i pjeses shkembore ne dy bazamentet e harkut te madh, te cilat kerkojne një trajtim special mbrojtje dhe injektim me presion me pomp me llac cimento  $\frac{1}{2}$  me rere te lare guri .
- Realizimi i një mbrojtje me gabiona si pas zhvillimit te pjesave shkembore ne shtratin e lumbit





Punoi :

Sabrina Kuci

Çesk Gjuraj

DRTK SHKODER

MIRATOHET

Sekretari K.K.T.K.M

Ark. Arta Dollani



### SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti : Restaurim dhe konservim Ura e Mesit, Shkoder (faza e pare).

Adresa : Njesia Administrative Postrive, Bashkia Shkoder

Gjate punes ne objekt per realizimin e projektit te parashikuar duhet te kihet parasysh qe realizimi perfundimtar i punes duhet te jete ne perputhje me specikimet e dhena. Specifikimet teknike jane te shtjelluar ne baze te zerave te preventivit te cilat jane edhe proceset e punes qe do zhvillohen ne objekt.

#### 1- Pastrim nga bimësia e ulët + injektim i solucionit per tharjen e bimeve te keqija

Ne bimesi te ulet do perfshihen barerat, shkurret dhe bime me diameter te vogel. Pastrimi i tyre do te behet ne menyre mekanike. Pasi te behet pastrimi i cili eshte do te behet ne menyre mekanike do te behet injektimi i solucionit . Te gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do te grumbullohen dhe te largohen nga objekt

#### 2- Prerje dhe tharje te rrenjeve masive (raundap 200cc)

Nisur nga gjendja ekzistuese eshte pare se ne vend ka peme ne lartesi deri 3 m te cilat demtojne monumentin. Pastrimi i tyre do te behet ne menyre mekanike. Te gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do te grumbullohen dhe te largohen nga objekt

#### 3- Pastrim nga bimësia e ulët muri ne lartesi

Monumenti ka mure rrethuese deri ne lartesi 3 m tek te cilet kane mbire bime te vogla si fieri, te cilat kane rrenje te vogla dhe nje kercell te shkurter. Pastrimi i tyre do te behet ne menyre mekanike. Te gjitha mbetjet e nxjerra nga pastrimi mekanik i tyre do te grumbullohen dhe te largohen nga objekt

#### 4- Fugatim muri (pastrim mekanik + larje me uje + fugatim)

Pasi eshte percaktuar se ku do kryhet procesi i fugatimit merren masat per sigurimin e zones perreth saj. Ne rast nevoje skelerie do te ngrihen dhe te instalohen sipas kushteve teknike te zbatimit. Pas instalimit te skelerive do te behet pastrimi mekanik me furce ose vegla te forta ne zonat e percaktuara ne projekt dhe ne rast zonash ne nevoje te behet pastrimi i tyre. Faza tjeter e fugatimit eshte ajo e largimit te pluhurave te tepert. Largimi i tyre te behet me furca dhe

fshesa. Ne rast se pastrimet mekanike jane te thella te perdoret kompresor ajri per pastrimin pluhurave. Pasi eshte bere pastrimi mekanik dhe larja me uje e hapsires qe do fugatohet behet perqatitja e llacit mbushes te gelqeres ne reportin 1:3. Mbushja te behet e plete dhe te ruhet njetrajtshmeria e mbushjes ne te gjithe zonen e percaktuar sipas projektit.



#### 5- Restaurim kalldrem 15-20cm

Gurët që do përdoren për shtrim, duhet të jenë sipas dimensioneve te atyre ekzistuesve, te marre ne zonen perreth ures dhe sipas konfigurimit të propozuar ne projekt, duke ruajtur menyren ekzistuese te vendosjes. Siperfaqja e sipërme e gurit duhet të jetë natyrale por qe lehteson qarkullimin mbi te.

#### 6- Realizimi i dranazheve per largimin e ujrave te shiut

Ne pjesen hyrese te ures ( Krahu Verior ) dhe ne dalje ( Krahu Jugor ) eshte e nevojshme te krijohet kanale shkarkimi te ujrate te bardha te shiut ,te mbuluara me zgara hekuri , (tip gradaresh) pasi ne raste rreshjesh I gjithe materiali I ngurte depozitohet ne pjesen kulluese te ures. Pozicioni i ketyre do te behet ne ato pjese te ures, ku nuk cenohet objekti monument kulture. Kuneta kulluese duhet te kete dimensione 1m gjeresi me thellesi 20 cm. Ne pjesen hyrese duhet patur pasasysh te jepet pjerresi ne menyre qe kullimi te behet ne faqen e jashtme te monumentit, ndersa ne pjesen dalese do te jete i njetrajshem ne menyre qe ujrat te kullojne ne te dy drejtimet.

#### 7- Restaurim i parapetit te ures

Parapeti I ures eshte I restauruar pjeserisht , por nga cilesia le per te deshiruar. Mendimi jone eshte kapuçimi I gjithë parapetit te ures ( te dy krahet) me gure te te njejtës ngjyrë dhe forme si gurat egzistus te qemerve te ures , vendosur mbi një shtres te holle llaci, me permasa respective ne gjersin e parapetit ( 30 x20 deri 30 x 5) cm,